

Rregullore e Komisionit (KE) nr. 1069/1999 e 25 majit 1999 që përshtat progresin shkencor dhe teknik të Rregullores së Këshillit (KEE) nr. 3922/91 (tekst kuptimi i të cilit lidhet me ZEE)

Gazeta Zyrtare L 130 , 26/05/1999 fq. 0016 - 0017

Rregullore e Komisionit (KE) nr. 1069/1999 e 25 majit 1999

që përshtat progresin shkencor dhe teknik të Rregullores së Këshillit (KEE) nr. 3922/91 (tekst kuptimi i të cilit lidhet me ZEE)

Komisioni i Komuniteteve Europiane,

Duke pasur parasysh Traktatin Themelues të Komunitetit European,

Duke pasur parasysh Rregulloren e Këshillit (KEE) nr. 3922/91 e 16 dhjetorit 1991 mbi harmonizimin e kërkesave teknike dhe procedurave administrative në fushën e aviacionit civil [1] siç është ndryshuar së fundi nga Rregullorja e Komisionit nr. 2176/96 [2], dhe veçanërisht neni 11 i saj,

(1) Duke pasur parasysh se Rregullorja (KEE) nr. 3922/91 siguron që Komisioni të bëjë ndryshimet që nevojiten nga progresi shkencor dhe teknik i kërkesave teknike dhe procedurave administrative të përbashkëta të renditura në Shtojcën II të saj dhe duke pasur parasysh se ndryshime të tilla, veçanërisht për të përmirësuar kërkesat e sigurisë, janë tashmë të përshtatshme;

(2) Duke pasur parasysh se JAR 1 – “Përkufizimet” është ndryshuar për të futur përkufizime të mëtejshme që lidhen me transportin ajror tregtar;

(3) Duke pasur parasysh se JAR 22 – “Planerët dhe planerët me motorë” është ndryshuar për të futur konceptin e planerëve që e mbajnë vetveten me energji dhe për të përditësuar nënpjesë të ndryshme të tij;

(4) Duke pasur parasysh se JAR 25 – “Aeroplanët e mëdhenj” është modifikuar për të përfshirë ndryshimet e pranura të kodit të barasvlershëm amerikan (FAR 25) dhe për të futur kërkesat e përditësuara që rrjedhin nga aktivitetet e harmonizuara të JAA/FAA dhe për të përmirësuar APU dhe kërkesat e pilotit automatik;

(5) Duke pasur parasysh se JAR AWO – “Funksionimi në çdo mot” është përditësuar për të futur kërkesat, midis të tjerash ato që lidhen me afrimin dhe uljen me një motor jofunksional;

(6) Duke pasur parasysh se JAR E – “Motorët” është ndryshuar për të futur kërkesat e përditësuara që rrjedhin nga harmonizimi i FAA/JAA dhe për të përmirësuar përputhshmërinë me JAR – 21 dhe JAR-et e tjerë;

(7) Duke pasur parasysh se JAR P – “Helikat” është ndryshuar për t’u përputhur me JAR – 21;

(8) Duke pasur parasysh se JAR APU – “Njësia rezervë e energjisë” është ndryshuar për t’u përputhur me JAR – 21;

(9) Duke pasur parasysh se JAR TSO - “Urdhrat standarde teknike” është ndryshuar për të rishikuar TSO ekzistuese dhe për të futur TSO të reja (p.sh. regjistruarit e zërit në kabinën e pilotit);

(10) Duke pasur parasysh se masat e parashikuara në këtë rregullore janë në përputhje me mendimin e Komitetit të Rregulloreve të Sigurisë së Aviacionit [3],

KA MIRATUAR KËTË RREGULLORE:

Neni 1

Shtojca II e Rregullores së Këshillit (KEE) nr. 3922/91 zëvendësohet me Shtojcën e kësaj rregulloreje.

Neni 2

Kjo rregullore hyn në fuqi 20 ditë pas botimit të saj në Gazetën Zyrtare të Komuniteteve Europiane.

Kjo rregullore është detyruese në tërësinë e saj dhe drejtpërdrejt e zbatueshme në të gjitha Shtetet Anëtare.

Nënshkruar në Bruksel, më 25 maj 1999.

Për Komisionin

Neil KINNOCK

Anëtar i Komisionit

[1] GZ L 373, 31.12.1991, fq. 4.

[2] GZ L 291, 14.11.1996, fq. 15.

[3] Komiteti i Rregulloreve të Sigurisë së Aviacionit, këshillim me shkrim i 4 shkurtit 1999.

SHTOJCË

"SHTOJCA II

Lista e kodeve në fuqi që përmbajnë kërkesat teknike dhe procedurat administrative të përbashkëta të përmendura në nenin 3

1. Të përgjithshme dhe procedura

JAR 1 Përkufizime dhe shkurtime deri në dhe duke përfshirë ndryshimin 5, datë 15 korrik 1996 dhe ndryshimin 1/97/1, datë 12 dhjetor 1997

2. Certifikata tip e produkteve dhe pjesëve

JAR 22 Planerë dhe planerë me motorë deri në dhe duke përfshirë ndryshimin 5, datë 28 tetor 1995

JAR 25 Aeroplanë të mëdhenj deri në dhe duke përfshirë ndryshimin 25/96/1, datë 19 prill 1996

JAR AWO Funksionim në çdo mot deri në dhe duke përfshin ndryshimin 2, datë 1 gusht 1996

JAR E Motorë deri në dhe duke përfshirë ndryshimet E/961, datë 8 gusht 1996 dhe E/97/1, datë 30 dhjetor 1997

JAR P Helika deri në dhe duke përfshirë ndryshimin P/96/1, datë 8 gusht 1996

JAR APU Njësi rezervë të energjisë deri në dhe duke përfshirë ndryshimin APU/96/1, 8 gusht 1996

- JAR TSO Urdhrat standarde teknike deri në dhe duke përfshirë ndryshimin 3, datë 28 prill 1996
- JAR VLA Aeroplanë shumë të lehtë deri në dhe duke përfshirë ndryshimin VLA/92/1
- JAR 145 Organizata mirëmbajtjeje të miratuara si më datë 1 janar 1992"